



DeckFinish Color

Ngjyra të ndryshme

IZOLIMI



Arri nivelin tjetër: Mbrojtja kundrejt rrezeve ultra-violet dhe kundrejt faktorëve të motit për verandën tuaj që zgjat shumë!

Shtresë 1K me bazë uji për sipërfaqe druri në ambientet e jashtme. Ky ekspert outdoor e nxjerr në pah në mënyrë të përkryer verandën tuaj: Nuk ka rëndësi nëse është në gri moderne ose në kafe në të kuqe fisnike – me jetëgjatësi ekstreme, DeckFinish Color i kundërvihet të gjitha kushteve të motit, është e sigurt kur shkelet dhe rezistente kundrejt klorit. Nëpërmjet përpunimit të saj të shpejtë dhe të thjeshtë, mbrojtja e fortë e sipërfaqes shkurton gjithashtu edhe kohën e punës.

- Mbrojtje në thellësi kundrejt rrezatimit ultra-violet, ngricës dhe lagështirës
- Rezistent kundrejt klorit
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Nuk kemi ashpërsim të drurit
- Kohë e shkurtër tharje
- I përshtatshëm për të gjitha llojet e drurit
- I përshtatshëm për dërrasa të lëmuara dhe të valëzuara
- I përdorshëm në sistem me LOBA DeckPrepare

Gama e përdorimit:

E përshtatshme për verandat prej druri dhe dyshemetë në ambientet e jashtme. Rezistencë ndaj rrëshqitjes sipas grupit të vlerësimit A DIN 51097 dhe grupit të vlerësimit DIN EN 16165:2021-12 R10.

Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
11842	5l	4	128

Magazinimi dhe transportimi

12 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit.
Material i parrezikshëm sipas ADR.
Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.

800145
Kafe e hapur800150
Kafe e errët800099
E kuqe në kaf900148
Gri

Pa garanci për ngjyrën

Udhëzime përpunimi

- Kushti optimal i përpunimit në +15°C deri +25°C, lagështia relative e ajrit 40% deri 75%, temperatura e materialit +15°C deri +25°C.
- Mos e vendosni mbi pjesët e nxehta ose mbi sipërfaqet e ekspozuara kundrejt rrezeve të diellit, duke qenë se shtresa e vendosur mund të thahet shumë shpejt. Mos e vendosni, nëse brenda 3 orëve pas vendosjes pritet të bjerë shi.
- Nëse keni dyshimi, krijoni një sipërfaqe testimi për të përcaktuar përputhshmërinë, ngjitjen dhe optikën. Rezultatet mund të ndryshojnë në varësi të llojit të drurit, sidomos në rastin e llojeve të druve që përmbajnë vaj, me ngjyra intensive dhe rrëshirë.
- Tundni mirë materialin.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Mënjanoni formimin e bulëzave mbi sipërfaqe, ose sheshojeni menjëherë me penel ose furçë.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.

HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Furçë vaji LOBATOOL, penel / 100-120ml/m². Konsumi faktik i materialit mund të ndryshojë në varësi të llojit të drurit, të lagështisë së drurit dhe të gjendjes së ekspozimit kundrejt motit të sipërfaqeve. Në rastin e sipërfaqeve që janë ekspozuar shumë kundrejt motit duhet të llogarisni me një konsum shumë më të lartë të materialit.

KOHA E THARJES

- Përpunim pas 2-3 orësh, brenda 24 orëve.
- Sforcim i lehtë pas tharjes gjatë natës.
- Ngarkesë e plotë pas 48 ditësh.

TRAJTIMI PARAPRAK

- Këshillohet trajtimi me LOBA DeckPrepare për optimizimin e karakteristikave të ngjitjes dhe për t'ju kundërvënë marrjes së ngjyrës gri nga ana e drurit.

PËRGATITJA:

Trajtimi i parë

- Përgatiteni nënshtresën në përputhje me të dhënat për "dysheme të vjetra të përdorura", ose "dysheme të reje të instaluar" te informacioni teknik mbi produktin LOBA DeckDegrayer.
- Aplikoni LOBA DeckPrepare në përputhje me informacionin teknik.
- Tharje për 1 orë. Prisni tharjen e plotë.
- Vendosni LOBA DeckFinish Color
- Tharja të paktën 2 orë
- Vendosni shtresën e dytë LOBA DeckFinish Color

Trajtimi pasues

- Pastrim themelor me LOBA DeckDegrayer në përputhje me informacionin teknik mbi produktin
- Vendosni LOBA DeckPrepare
- Tharja të paktën 2-3 orë
- Vendosni LOBA DeckFinish Color

Për ruajtjen e vazhdueshme të vlerave optike ne rekomandojmë një pastrim vjetor themelor dhe një shtresëzim të ri të dyshemesë së verandës.

Udhëzime të përgjithshme

Koha e tharjes: Kohët e dhëna të tharjes vlejnjë në +20°C dhe në 50% lagështirë ajri relative. Temperaturat më të ulëta, lagështia relative më e lartë e ajrit shkakton vonesa të tharjes. Para arritjes së fortësisë finale mos pastroni me leckë të lagur. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Përdorimi i LOBA DeckFinish Color në montimin e plotë:

Parimisht LOBA DeckFinish Color mund të përdoret pa LOBA DeckPrepare. Përdorimi i LOBA DeckPrepare përmirëson shumë karakteristikat e ngjitjes së llakut kundrejt dyshemesë dhe rrit sigurinë e përpunimit.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.